

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare me 31 Dhjetor 2025.

1. Informacion i përgjithshëm

Gjendja e regjistrimit të “SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR” me 31 Dhjetor 2025 është si ne vijim,

Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) është M41828022F.

Data e Regjistrimit është 28/06/2024.

Emri i Subjektit është UNIK CONSTRUCTION (në vijim referuar si “shoqëria”).

Forma ligjore është SHPK.

Data e themelimit është 21/06/2024.

Kohëzgjatja e shoqërisë është nga: 21/06/2024 deri Pa afat.

Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri është Njesia Bashkiake Vore, Koder Vore, Zona kadastrale 2183, Nr.pasurie 103/17,Vore.

Kapitali i shoqërisë është 10.000.000,00 lekë, numri i përgjithshëm i kuotave është 1,00.

Objekti i aktivitetit është në fushën e Ndertimit dhe në fushën e Tregetise me pakice e shumice e mallrave industriale.

Administratori është Skifter Picari, me afat emërimi deri më 21/06/2029.

Ortakët e shoqërisë janë;

Skifter Picari me vlerë kapitali 10.000.000 leke, numër pjesësh 1 dhe pjesëmarrje në përqindje (%) 100.

Më datë 31 Dhjetor 2025 shoqëria ka të regjistruar 4 (kater) punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK).

Drejtimi i Shoqërisë vlerëson që Shoqëria do të vijojë aktivitetin normal tregetar për 12 muajt që pasojnë muajin e mbylljes së këtyre pasqyrave financiare. Për rrjedhojë, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2025 janë përgatitur në baze të të parimit të vijimësisë.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes



Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.4 Vleresime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrijnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të kompanisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të ketyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken nga rivlerësimi.

Në veçanti, informacionet mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumën e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat kontabel

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në periudhën që fillon më 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2025.

3.1 Transaksionet në monedhe të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kursi i këmbimit valutor në 31 Dhjetor 2025 është 96.77 Lekë/Euro dhe 82.46 Lekë/Usd.

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhena, dhe llogari të pagueshme.



Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentët të saj përfshijnë depozita pa afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbriturhumbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar, mospagesa ose vonesa në pagesa konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar në interesin efektiv.

Të tjera



Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

3.3 Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjëndje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjëndjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjate material kane jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që Shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjate material dhe duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.4 Zhvlerësimi

Aktivët financiarë

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.



Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo shpenzim i akumuluar i lidhur me një aktiv financiar i disponueshëm për shitje i njohur me parë në kapital, transferohet në shpenzime.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitetet jo-financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo-financiare të shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.5 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë.

3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat nga shërbimet e ofruara njihen në pasqyrën e të ardhurave në varësi të fazës së përfundimit të transaksionit në datën e bilancit. Asnjë e ardhur nuk njihet nëse ka pasiguri të lartë lidhur me kryerjen e pagesës dhe kostove perkatëse.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë



të drejte nëpërmjet fitim/humbje, dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore të miratuara në periudhën e raportimit.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare me 31 Dhjetor 2025 janë perbere si me poshte;

Mjetet monetare	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Vlera monetare në bankë	388,900	178,787
Vlera në arkë	5,000	17,412
Vlera në arkë në valutë	0	0
Fonde të bllokuara në banke (garanci)	0	0
Totali	393,900	196,199

5. Llogari te arketueshme

Llogarite e arketueshme deri me 31 Dhjetor 2025 janë perbere si me poshte;

Llogari te arketueshme	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Klientë për mallra, produkte e shërbime	0	3,814,536
Totali	0	3,814,536

6. Llogari te tjera te arketueshme

Llogari te tjera te arketueshme deri me 31 Dhjetor 2025 janë perbere si me poshte;

Llogari te tjera te arketueshme	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Furnitorë për mallra, produkte e shërbime	0	0
Premtim pagesa të pagueshme	0	0



Furnitorë për aktivet afatgjatë	0	0
Parapagime te marra	0	7,643,016
Parapagime te dhena	0	0
Tatim mbi fitimin	0	282,964
TVSH	790,782	5,913,049
Taksa e detyrime ne dogane	78	78
Të tjera tatime pët'u paguar dhe për t'u kthyer	0	271,570
Tatime te shtyra	0	0
Tatimi në burim	0	0
Te drejta dhe detyrime ndaj ortakeve dhe aksionereve	0	0
Ort.:Kapitali nenshkruar pa derdhur	9,208,160	0
Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë	0	158,198,540
Huadhënie afatshkurtër	0	0
Totali	9,999,020	172,309,217

7. Inventarë

Llogaria inventarë me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

Inventarët	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Materiale të para	0	0
Materiale të tjera	0	0
Objekte inventari	0	0
Amballazh i kthyeshem	0	0
Inventar i imet	0	0
Prodhimi ne proces	0	0
Punime ne proces	0	0
Shërbime ne proces	0	0
Produkte të gatshëm	0	0
Produkte të ndërmjetëm	0	0
Nënprodukte dhe produkte mbeturinë	0	0
Mallra	3,780,504	27,161,217
Totali	3,780,504	27,161,217

8. Shpenzime te shtyra / Te ardhura te konstatuara

Llogaria shpenzime te shtyra-te ardhura te konstatuara deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;



	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
<u>Shpenzime të shtyra / Te ardhura të konstatuara</u>		
Shpenzime të periudhave të ardhme	0	0
Të ardhura të periudhave të ardhme	0	0
Zhvierësime të tjera për aktivet financiarë	0	0
Totali	0	0

9. Aktivët afatgjatë

Llogaritë e aktiveve afatgjatë deri më 31 Dhjetor 2025 janë përbërë si më poshtë;

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
<u>Aktivët afatgjatë jomateriale</u>		
Emri i mirë	0	0
Shpenzime të zhvillimit	0	0
Koncesione dhe të drejta të ngjashme, licenca të ngjashme	0	0
Të tjera AA jomateriale	0	0
AA jomateriale në proces	0	0
Amortizim-Aktivët afatgjatë jomateriale	0	0
Totali	0	0

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
<u>Aktivët afatgjatë materiale</u>		
Toka	0	33,143,100
Ndërtesa	0	30,645,025
Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente dhe vegla pune	0	0
Mjete transporti	10,164,300	38,048,713
Të tjera AA materiale	0	3,002,774
AA materiale në proces	0	92,423,565
Amortizimi i AA materiale	0	-1,613,024
Totali	10,164,300	195,650,153

10. Llogaritë të pagueshme

Llogaritë e pagueshme deri më 31 Dhjetor 2025 janë përbërë si më poshtë;

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Llogaritë të pagueshme		



Furnitorë për mallra, produkte e shërbime	10,855,688	33,691,218
Totali	10,855,688	33,691,218

11. Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtra deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

Detyrimet afatshkurtra	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Mallra per shitje	0	0
Zhvlerësimi i mallrave për shitje	0	0
Paradhenie per furnizim	5,333	0
Premtim pagesa të arkëtueshme	0	0
Klientë për aktivet afatgjata	0	0
Të drejta për t'u arkëtuar nga proceset gjyqësore	0	0
Parapagime të dhëna	0	333,161,610
Paga dhe shpërblime	249,418	465,199
Të drejta dhe detyrime ndaj ortakëve dhe aksionerëve	0	0
Dividentë për t'u paguar	0	0
Huamarrje afatshkurtëra	0	0
Totali	254,751	333,626,809

12. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

Detyrimet tatimore	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Sigurime shoqërore dhe shëndetsore	50,209	119,396
Akciza	0	0
Tatim mbi të ardhurat personale	3,245	28,332
Tatime të tjera për punonjësit	0	0
Tatim mbi fitimin	0	0
TVSH	0	0
Taksa e detyrime ne dogane	0	0
Të tjera tatime për t'u paguar dhe për t'u kthyer	0	0
Tatime te shtyra	0	0
Tatimi në burim	0	0
Totali	53,454	147,728



13. Detyrimet afatgjata

Detyrimet afatgjata deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

Detyrimet afatgjata	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Qera financiare	0	0
Grante	0	0
Huamarrjet afatgjata	4,130,033	0
Huamarrjet afatgjata	0	0
Te ardhura te periudhave te ardhme	0	0
Totali	4,130,033	0

14. Kapitali i vet

Kapitali i vet deri me 31 Dhjetor 2025 eshte i perbere si me poshte;

Kapitali i vet	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Kapitali i paguar	0	29,740,000
Kapitali i nenshkruar i papaguar	10,000,000	10,000,000
Rezerva te tjera	0	0
Fitimi/Humbja e pashpërndarë	0	-956,203
Rezultati i ushtrimit	-956,203	-7,118,230
Totali	9,043,797	31,665,566

15. Te ardhurat nga aktiviteti

Te ardhurat nga aktiviteti deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

Te ardhurat	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Shitje e produkteve të gatshëm	0	0
Shitje e produkteve të ndërmjetëm	0	0
Shitje e nënprodukteve	0	0
Shitje e punimeve dhe e shërbimeve	0	0
Shitje mallrash	8,470,250	0



Shitje e punimeve dhe e sherbimeve	0	65,191,023
Shitje materiale e furnitura	0	0
Të ardhura nga shitje të tjera	0	0
Prodhimi i aktiveve afatgjatë	0	0
Prodhimi i AA jomaterialë	0	0
Të ardhura nga grantet	0	0
Të ardhura nga grantet	0	0
Të ardhura të tjera korente	0	0
Të ardhura nga shitja AA	0	0
Të ardhura të tjera korente	0	0
Te ardhura Credit note	0	0
Te ardhura nga shitja e mjeteve te transportit	0	0
Totali	8,470,250	65,191,023

16. Materiale te konsumuara

Materialet e konsumuara deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

Materiale te konsumuara	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Blerje/Shpenzime të konsumuara	0	0
Materiale të tjera	0	0
Ndryshim gjendje inventari	13,944,804	28,859,586
Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	-22,415,054	-28,859,586
Totali	-8,470,250	0

17. Te tjera shpenzime

Te tjera shpenzime deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

Te tjera shpenzime	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Blerje,energji,avull,uje	0	0
Blerje Energji Avull Uje	0	0
Blerje punime e sherbime	0	-59,736,363
Blerje të pastokueshme	0	0
Blerje /shpenzime te tjera	0	-257,431
Zbritje ne blerje	0	0
Totali	0	-59,993,794



18. Shërbime nga te tretet

Shërbime nga te tretet deri me 31 Dhjetor 2025 janë përbërë si më poshtë;

Shërbime nga te tretet	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Trajtime të përgjithshme	-136,000	-1,274,328
Komisione ndërmjetesimi	0	0
Qira	-414,704	-1,804,410
Mirëmbajtje dhe riparime	0	0
Sigurime	-17,670	-404,661
Kërkime dhe studime	0	0
Të tjera	-12,667	-1,362,764
Të tjera	0	0
Totali	-581,041	-4,846,163

Shërbime të tjera	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Personel jashtë njesisë	0	0
Komisione të ndërmjetësve dhe honorare	0	0
Shpenzime për konçesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	0	0
Publicitet, reklama	0	0
Transferime, udhëtime, dieta	0	0
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	0	-10,083
Shpenzime transporti	0	0
Shpenzime për shërbimet bankare	-5,471	-115,209
Tatim mbi qarkullimin dhe akciza	0	0
Taksa, tarifa doganore	-2,193	0
Taksa vendore	0	0
Taksa dhe tarifa vendore	0	-362,770
Taksa e regjistrimit	0	0
Tatime të tjera	-32,689	-546,909
Komisione të ndërmjetësve dhe honorare	0	0
Vlera e mbetur kontabel AA	0	0
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	0	0
Gjoha dhe dëmshpërblime	-911	-71,786
Shpenzime të tjera korente	0	-193,919
Zbritje akorduar klienteve	0	0



Zbritje akorduar klienteve	0	0
Vlera kontabel per instalime tekniket,makineri,pajisje	0	0
Totali	-41,264	-1,300,676

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Shpenzim amortizimi		
Shpenzim amortizimi i AA Jomateriale	0	0
Amortizimet e aktiveve afatgjatë	0	-1,613,024
Totali	0	-1,613,024

19. Shpenzime per personelin

Shpenzimet per personelin deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Shpenzime per personelin		
Pagat dhe shpërblimet e personelit	-381,778	-2,215,984
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	-77,402	-379,079
Kontribute dhe kuota të tjera për personelin	0	0
Shpenzime të tjera për personelin	0	0
Totali	-459,180	-2,595,063

20. Te ardhurat / (shpenzimet) financiare

Te ardhurat / (shpenzimet) financiare deri me 31 Dhjetor 2025 jane perbere si me poshte;

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Te ardhura / (shpenzime) nga interesat		
Shpenzime për interesa	0	-151
Të ardhura nga interesat	0	29
Totali	0	-122

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Te ardhura / (shpenzime) nga kembimet valutore		
Humbje nga këmbimet dhe perkthimet valutore	-16,036	-2,345,174
Fitim nga kembimet valutore	141,317	384,762
Totali	125,281	-1,960,412



21. Shpenzimet per tatimin mbi fitimin

Shoqeria pergjate periudhes tatimore 2025 ka pergjegjesine tatimore te Tatimit mbi te Ardhurat korporative. Bazuar ne te ardhurat e realizuara ne kemi perpiluar deklaraten vjetore sipas te ardhurave dhe shpenzimeve tatimore.

Shpenzimet per tatimin mbi fitimin	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2025
Fitimi/(humbja) para tatimit	-956,204	-7,118,231
Shpenzime te panjohura sipas legjislacionit fiskal		
Blerje/Shpenzime të konsumuara		
Shërbime nga të tretët		
Shërbime të tjera		
Tatime dhe taksa		
Shpenzime për personelin		
Shpenzime të tjera të veçanta korrente	911	265,705
Shpenzime financiare		
Shpenzime te tjera jo korente		
Humbje te mbartura		
2022	0	0
2023	0	0
2024	0	-955,293
Fitimi/(humbja) para tatimit (pas rregullimeve)	-955,293	-7,807,819
Norma e tatimit mbi fitimin	15%	15%
Tatimi mbi fitimin 15%	0	0
Norma e tatimit mbi fitimin-Te tjera		
Tatimi mbi fitimin 5% / 10% / 23%	0	0
Tatimi mbi fitimin per periudhen	0	0

Deklaratat tatimore dorezohen çdo vit, por te ardhurat dhe shpenzimet e deklaruarra per qellime tatimi konsiderohen vetedeklarime deri ne momentin qe autoritetet tatimore shqyrtojne deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe leshojne vleresimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare jane objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.



Llogaritja e tatimit mbi fitimin eshte kryer ne baze te te ardhurave dhe shpenzimeve te realizuara nga UNIK CONSTRUCTION sh.p.k.

22. Angazhime dhe pasiguri


Gjate aktivitetit normal te biznesit, shoqeria mund te perfshihet ne pretendime te ndryshme nga te trete dhe masa ligjore. Vecanerisht, legjislacioni tatimor dhe doganor shqiptar i cili hyri ne fuqi ose qe konsiderohet si i hyre ne fuqi ne fund te periudhes raportuese, eshte objekt i interpretimeve te ndryshme per sa i perket zbatimit te tij per transaksionet dhe aktivitetet e Shoqerise. Rrjedhimisht, pozicioni tatimor ndermarre nga drejtimi dhe dokumentacioni zyrtar i cili mbeshtet qendrimet tatimore mund te kundërshtohet me sukses nga autoritetet perkatese. Periudhat fiskale mbeten te hapura per shqyrtim nga autoritetet per pese vite kalendarike para vitit te shqyrtimit. Nën rrethana te caktuara shqyrtimet mund te mbulojne periudha me te gjata.

Me 31 Dhjetor 2025, shoqeria nuk ka angazhime kapitale apo operacionale te kontraktuara por ende te papaguara.

23. Ngjarje te mepasshme

Nuk ka asnje ngjarje te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë më 31 Dhjetor 2025 për periudhën nga 01 Janar deri më 31 Dhjetor 2025 u aprovuan nga UNIK CONSTRUCTION sh.p.k. dhe u nënshkruan si më poshtë;


Z. / Znj. Skifter Picari
Përfaqësues ligjor

